



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova – Republic of Kosovo**  
**ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT**  
**TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE**  
**PROCUREMENT REVIEW BODY**

**AKT PËRCJELLËS**

Për:	Menaxherin e Prokurimit: Komuna Malishevë	Kopje:	Paneli Shqyrtues - OSHP
	OE ankues: “Arhiko Ing OP” “Studio hapësira” dhe “Eng Idea&SIB Bka”		246/19 275/19 278/19
Prej:	Visar Basha – Ekspert shqyrtues i prokurimit		
Lënda:	Raporti i ekspertit shqyrtues, lidhur me ankesat me Nr. 246/19 të parashtruar nga OE “Arhiko Ing OP” - Prishtinë		
Datë	17.06.2019		

Bazuar në nenin 114 të Ligjit Nr. 04/L-042 i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, ju njoftojmë me raportin, lidhur me ankesat e OE-ve ankues OE “Arhiko Ing OP” - Prishtinë, “Studio hapësira” - Prishtinë dhe OE “Eng Idea&SIB BKA”, lidhur me aktivitetin e prokurimit: “Hartimi i projekteve”, me numër të prokurimit: 62500-19-1228-2-2-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Komuna Malishevë.

AK është i thirrur që pas marrjes së raportit të ekspertit shqyrtues lidhur me këtë kërkesë, të veprojë sipas kërkesave të nenit 115 të LPP-së.

Të bashkangjitur gjeni raportin e ekspertit shqyrtues.

**Ti dorëzohet:**

- Autoritetit Kontraktues – KOMUNA MALISHEVË.
- Panelit Shqyrtues – OSHP.
- OE ankues – ARHIKO ING OP, STUDIO HAPËSIRA dhe ENG IDEA&SIB BKA

Raporti i ekspertit shqyrtues, lidhur me ankesën e parashtruar nga OE-të ankues, lidhur me aktivitetin e prokurimit “Hartimi i projekteve”, me numër të prokurimit: 62500-19-1228-2-2-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Komuna Malishevë.



Republika e Kosovës  
Republika Kosova – Republic of Kosovo  
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT  
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE  
PROCUREMENT REVIEW BODY

RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES

		06.06.2019	17.06.2019
Nënshkrimi i ekspertit		data e autorizimit të ekspertit.	data e dorëzimit të raportit

**N. 105, LPP - Baza ligjore e shqyrtimit**

Me datën: 27.05.2019, OE “Arhiko Ing OP” - Prishtinë, ka parashtruar ankesë në OSHP, kundër njoftimit për dhënie të kontratës ku është rekomanduar për kontratë OE “Pro Ing&Partners&Engineering Group” - Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit: **“Hartimi i projekteve”**, me numër të prokurimit: **62500-19-1228-2-2-1**, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – **Komuna Malishevë**.

Me datën: 03.06.2019, OE “Studio Hapësira” - Prishtinë, ka parashtruar ankesë në OSHP, kundër njoftimit për dhënie të kontratës ku është rekomanduar për kontratë OE “Pro Ing&Partners&Engineering Group” - Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit: **“Hartimi i projekteve”**, me numër të prokurimit: **62500-19-1228-2-2-1**, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – **Komuna Malishevë**.

Me datën: 27.05.2019, OE “Eng Idea&SIB Bka” - Suharekë, ka parashtruar ankesë në OSHP, kundër njoftimit për dhënie të kontratës ku është rekomanduar për kontratë OE “Pro Ing&Partners&Engineering Group” - Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit: **“Hartimi i projekteve”**, me numër të prokurimit: **62500-19-1228-2-2-1**, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – **Komuna Malishevë**.

Ankesat nuk janë te përsëritura.

Konform nenit 113, 114 të Ligjit Nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, Eksperti Shqyrtues i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues.

**Operatorët Ekonomik Ankues – dispozitat e shkelura:**

Raporti i ekspertit shqyrtues, lidhur me ankesën e parashtruar nga OE-të ankues, lidhur me aktivitetin e prokurimit **“Hartimi i projekteve”**, me numër të prokurimit: **62500-19-1228-2-2-1**, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – **Komuna Malishevë**.



**AK ka shkelur keto nene dhe rregulla:**

**Kushtet e percaktuara me deklarate nen betim**

**Neni 7 i LPP: Barazia ne Trajtim/ Jo-Diskriminimi**

**Neni 59 i LPP: Ekzaminimi, Vleresimi dhe Krahassimi i tendereve**

**Neni 65 Pranueshmëria e Kandidatëve ose Tenderuesve**

**Neni 66 Përshtatshmëria Profesionale**

**Neni 69 Aftësia Teknike dhe/ose Profesionale**

**Nenin 33 te ROUPP: Dorezimi elektronik i tendereve**

## **7. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet**

*Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të kërkesës suaj për rishqyrtim.*

**Shkelja 1:** Ne dosjen e tenderit te dorezuar, OE ka dorezuar kontrata te rregullta per stafin profesional me orar te plote perkunder faktit qe shumica e stafit kane kontrata te rregullta edhe ne vende tjera te punes. Menaxheri i projektit, z. Isak Idrizi eshte profesor ne nje nga universitetet e Shkupit. Kjo mund te deshmohej shume lehte. Eshte e jashteligjshme qe OE te kete kontrate me orar te plote 8 ore ne dite me kete inxhinier. Per me shume nenshkrimi i ketij inxhinieri dhe poashtu inxhinierëve tjere pretendojme qe nuk jane nenshkruar nga vete inxhinieret.

Ky veprim i OE bie ndesh me deklaraten nen betim. OE ne kete rast duhet jo vetem te eliminohet por edhe ndaj tij te mirren masa te metutjeshme per paraqitje te dokumenteve fiktive.

Rrjedhimisht OE i propozuar per kontrate nuk i ploteson kushtet dhe AK ne kete rast ka bere shkelje te nenit 59 te LPP duke e shpallur fitues nje OE qe nuk i permbushë kriteret e dhenies.

Kerkojme nga AK qe te kerkoje verifikimin e nenshkrimeve me kopje te leternjoftimit te nenshkruar dhe vertetim nga noteri per te gjithë inxhinieret e paraqitur nga OE.

**Shkelja 2:** Ne dokumentin “Rregullat dhe Udhezuesi Operativ per Prokurim Publik”, neni 33 percakton rregullat e dorezimit elektronik te tendereve. Aty kerkohet qe Formulari i shkarkuar nga sistemi te nenshkruhet me nenshkrim te avancuar dixhital. Per me shume thuhet:

33.9 Në rast se tenderi dorëzohet në emër të Grupit të Operatorëve Ekonomik, Formulari i Dorëzimit të Tenderit duhet të nënshkruhet nga personi i autorizuar, duke përdorur nënshkrimin e avancuar dixhital, në emër të grupit të OE

Formulari i dorezuar nga OE nuk eshte i nenshkruar ne menyre dixhitale sic kerkohet. Nenshkrimi i paraqitur eshte vetem editim i dokumentit, ku nenshkrimi eshte marre si foto dhe eshte vendosur ne dokument. Ky lloj nenshkrimi nuk eshte nenshkrim dixhital, per me teper eshte modifikim i formularit, i cili veprim eshte i ndaluar ne nenin 33.8 te ROUPP. Rrjedhimisht OE nuk ka plotesuar si duhet Formularin e Tenderit dhe sipas nenit 39.8 te ROUPP, eshte kusht administrativ qe AK te rrefuzojë tenderin pa kerkuar informacione shtese

**Shkelja 3:** Partneri i koncersuimit ka paraqitur certifikatat e vjetra te regjistrimit e cilat

tanime nuk jane valide pasiqe Ministria e Tregtrise dhe Industrise- Agjencia per regjistrimin e bizneseve ka bere nderrimin e certifikatave te biznesit per te gjitha kompanite, dhe secila komani eshte e obliguar te pajiset me certifikate te re. Per me shume neni 3.12 i ROUPP i obligon te gjithë operatorët ekonomik qe te perditesojne te dhenat e tyre. Ne rastin kontrak partneri i koncersiumit nuk ka perditesuar te dhenat, vazhdon te operoje me numer te vjeter te biznesit, edhe pse ne platformen e ARBK i figuron numri unik identifikues i ri, i cili duhet te perdoret.

Nga kjo qe u tha me larte dhe argumentet e ofruara, kerkojme nga AK te rishqyrtoj vendimin, te eliminoje AK Proing & Partners dhe te shpalle fituese kompanine tone pasiqe i permbushim te gjitha kushtet e kerkuara.

## 8. Dëmet materiale

*Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar ka shkaktuar ose kërcënohet t'iu shkaktojë dëme materiale, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.*

Shpenzimet e tenderimit  
Mundesia e nenshkrimit te kontrates

## 9. Lista e dokumenteve (dëshmime) të bashkangjitura

*Nëse aplikohet, bashkëngjitni kërkesës dokumentet e renditura më poshtë:*

- a) një kopje të publikimit të "Njoftimit për Kontratë" apo "Njoftimit për Konkurs të Projektimit.
- b) një kopje të publikimit për "Njoftimin e Dhënies së Kontratës" apo "Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimit për Anulim".
- c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.
- d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet.



## 7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

*Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs të Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.*

**NENI 7 : Barazia në trajtim / jo-diskriminimi.**

**NENI 10 : Mjetet për promovimin e transparencë.**

**NENI 24 : Zyrtaret e prokurimit gjatë ushtrimit të aktiviteteve të prokurimit.**

**NENI 27 : Dosja e tenderit.**

**NENI 28 : Llojet e specifikimeve teknike.**

**NENI 40 : Njoftimi i kontratës.**

**NENI 51 : Njoftimi i kriterëve të dhënies kontratës.**

**NENI 56 : Dizpozita e përgjithshme mbi përzgjedhjen e pjesëmarrësve dhe dhënien e kontratave .**

**NENI 59 : Ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve.**

**NENI 60 : Kriteret për dhënien e kontratës .**

**NENI 64 : Dëshmi Kërkesa.**

**NENI 67 : Provat shkresore .**

**NENI 69 : Aftësia teknike dhe /ose profesionale.**

*\*\* Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkojë një gjabje shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kanë qenë të rrejshme ose mashtruese.*

## 8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

*Përkthyeri rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.*

Më datën 20.05.2019 përmes -Formulari Standard B42 , jemi njoftuar nga AK se jemi eliminuar me arsyetimi kemi bërë gabime aritmetikore.

**1..Ju keni bërë gabim në llogaritjen e çmimeve.**

Grupi i Operatoreve Ekonomik "Studjo Hapësira"ShPK dhe "Taulant" shpk çmimin e hapjes e ka ofruar 1.13€,ndersa komisioni i vlerësimit gjatë llogaritjes së çmimeve ka gjetur një gabim të bërë nga OE në pozicionin e Hartimi i Projektit Ideor dhe Kryesor -Për Ndërtimin e Rrugëve .çmimi i peshuar i llogaritur nga kompanija është 0.38€,ndersa duhet të jetë 0.405€ dhe në Poz.C Hartimi i Projekteve Ideore dhe Kryesore -Objekte Hidroteknike .çmimi i hapjes është 0.23€



- **Demonstrimi 2 . (Për kalkulimi e saktë të përqindjes së gabimeve aritmetikore ofertën e ngarkuar e llogaritim me tri decimale )**

Vlera totale e peshuar me tri decimale është 1.133€

Vlera totale e peshuar e korigjuar nga Autoriteti Kontraktues është 1.155€

Diferenca e gabimit aritmetikore është 0.022€

Kalkulimi i përqindjes sipas Demonstrimit 2

$$(0.022€ / 1.155€) \times 100\% = 0.0190 \times 100\% = 1.90\% \text{ ( Gabimi aritmetikor)}$$

Si provë materiale e ngarkojmë në sistem edhe fajllin në exell të ngarkuar në platformën elektronike.

#### **PËRFUNDIM :**

Bazuar në argumentet e specifikuar më lartë, dhe duke mos marrë për bazë decimale e tretë e specifikuar në NENI 20 .1 të FDT ,konsiderojmë që oferta jonë nuk ka gabime aritmetikor më shumë se 2% dhe konsiderojmë oferta jonë është e përgjegjshme me qmimin me të ultë e përcaktuar me ligjin e prokurimit publik .

Duke u bazuar në argumentet e specifikuar më lartë kërkojmë nga AK të bëjë anulimin për dhënie Kontratës , e njëjta ta kthejë lëndën në rivlerësim dhe të marrë si të bazuar kërkesën tonë për ri-shqyrtim të lëndës , pasi konsiderojmë që AK gjatë këtij aktiviteti të prokurimit në masë substanciale nuk e ka rrespektuar LPP

#### **9. Dëmet materiale**

*Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.*

Shkeljet e supozuara kanë shkaktuar dëmtim të imazhit kompanisë , një numër i konsiderueshëm të punëtorve kanë mbetur pa punë , duke llogaritet shpenzimet , kamatatë , tarifën e avokatit deri sa të zgjidhen kontekstet.

Vlera e dëmit kap vlerën 150, 000.00€, të cilën Autoriteti Kontraktues është i obliguar të ja paguaj palës dëmtuar në rast se humb kontekstin Gjyqësorë

#### **10. Lista e dokumenteve (dëshmime) të bashkangjitura**

*Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:*

- a) një kopje të publikimit të "Njoftimit për Kontratë" apo "Njoftimit për Konkurs të Projektimit.*
- b) një kopje të publikimit për "Njoftimin e Dhënies së Kontratës" apo "Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimit për Anulim".*
- c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.*
- d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet,*



## 5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit? A keni bërë ndonjë reagim me shkrim dhe/ose kërkuar sqarime shtesë nga AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj, si dhe a u është përgjigjur me shkrim AK në lidhje me këtë? Nësepo, ofroni shkurtimisht detaje mbi këtë fakt:

Po	<input checked="checked" type="checkbox"/>				Jo	<input type="checkbox"/>	
----	--	--	--	--	----	--------------------------	--

Letren stadarten permes E-prokurimit me daten 15.03.2018

## 6. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga moment i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs të Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

AK gjate zhvillimit të këtij aktiviteti të prokurimit, konkretisht gjatë procesit të Ri-vlerësimit të tenderëve ka bërë shkelje të dispozitave të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092.

1. - AK ka shkelur nenin 1, 6, 7, 59.4, 60.1.1, 61 dhe 62, 64.3 të LPP Nr.04/L-042 të amandamentuar

## 7. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

Pretendimi 1: Komisioni i AK gjatë fazës së vlerësimit të tenderit ka bere shkelje te LPP, ne nenet e cekura ne piken 6, duke mos vlerësuar drejt kur ka konstatuar te shpalle fitues OE PROing & Partners sh.p.k. & Engineering Group sh.p.k., pasi qe nuk ka vleresuar oferten financiare dhe ka anashkaluar çmimet jo-normalisht të ulëta te ofruar nga grupi i OE te shpallur fitues, duke shkele direkt Neni 61, Tenderët Jo-Normalisht të Ulët, pika 1. Nëse një operator ekonomik e dorëzon një tender që, është ose duket të jetë jo-normalisht i ulët, autoriteti kontraktues do të dërgojë një kërkesë me shkrim tenderuesit ku kërkohet nga tenderuesi që të dorëzojë me shkrim : (i) një ndarje të elementeve përbërëse të tenderit dhe (ii) shpjegime në lidhje me bazën e tenderit...".



Sipas rregullores B57 Rregullat per tenderet Jo Normalisht te Ulet te adoptuara nga KRPP, vertetohet se oferta e dorezuar nga OE ankimues duhet te shpallet oferta fituse. Me poshte po ju paraqesim kete pretendim ne menyre tabelare sikur edhe eshte spjeguar ne rregulloren B57:

Nr.	Lot 1			
	A	B	C	D
1	<b>kushti 1 - është përmbushur kushti i pare sepse janë pranuar 5 oferta</b>	<b>Pranuar 5 oferta te pergjegjshme sipas AK</b>		
2	1	Arhiko ING OP	1.24	
3	2	PROing & Partners & Engineering group	1.36	
4	3	ENG IDEA & SIB-BKA	1.77	
5	4	Infraplus sh.p.k. & Plan 2	3.36	
6	5	Infratek & Alfa i	2.96	
7		<b>Total (C2+C3+C4+C5+C6)</b>	<b>10.69</b>	
8		Mesatarja (C7/5)	2.14	
9		30% i mesatares (C8*30%)	0.64	
10	<b>kushti 2 - te gjitha ofertat nen ketë çmim përmbushin kushtin e dyte</b>	<b>pragu 30% (C8-C9)</b>	<b>1.50</b>	ne ketë rast vetëm oferta 1 dhe 2 përmbush kushtin e dyte prandaj vazhdohet me kushtin e trete
11		<b>10% ne mes dy ofertave (C4*10%)</b>	<b>0.18</b>	
12	<b>kushti 3 – pragu 10% ne mes ofertës me te lire ne krahasim me ofertën e dyte me te lire</b>	<b>pragu 10% (C4-C11)</b>	<b>1.59</b>	ne ketë rast ofertat 1 dhe 2 përmbush edhe kushtin e trete

Pretendimi 2. OE, ARHIKO ING OP, ka paraqitur diplomën e gjeodetit ne gjuhen Kroate, per te cilen nuk ka ofruar perkthimin adekuat ne njerën nga gjuhet zyrtare te prokurimit publik ne



Republikën e Kosovës, shqip, anglisht apo serbisht.

Pretendimi 3. Edhe pse AK na ka ofruar qasje në dokumentet e tenderit, AK nuk na ka ofruar qasje në çmimet e ofruara nga OE, pasi që i kanë cilesuar si informacione konfidenciale. Edhe këtu AK është në shkelje të ligjit pasi që oferta financiare nuk cilesohet si informacion sekret bazuar në nenin 11, 68 dhe 69 të LPP.

Në kërkojmë që Autoriteti Kontraktues të rishqyrtoj vendimin e tij, dhe të shpallë fitues OE NPN ENG IDEA & SIB-BKA SHPK si kompani të përgjegjshme me çmimin më të lirë.

### 8. Dëmet materiale

*Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar I ka shkaktuar ose kërcënohet të shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës:*

**Dëmi material për kompaninë tonë janë të mëdha si në aspektin moral dhe në imazhin tonë dhe humbjen e kohës si dhe shpenzimet administrative në vlerë 25000.00 Euro.**

### 9. Lista e dokumenteve (dëshmime) të bashkangjitura

*Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:*

- një kopje të publikimit të "Njoftimit për Kontratë" apo "Njoftimit për Konkurs të Projektimit.
- një kopje të publikimit për "Njoftimin e Dhënies së Kontratës" apo "Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimit për Anulim".
- një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës së tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës përmos para-kualifikim.
- një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, dhe
- Një kopje të Kërkesës për rishqyrtim
- Një kopje të vendimit të refuzimit të ankesës
- të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shënuar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.

**DEKLARATA DETALE MBI FAKTET DHE ARGUMENTET “ARHIKO ING OP”:**

Pretendimet ankimore te parashtruara ne ankesën e deponuar ne OSHP, nuk janë te njëjta.

**DEKLARATA DETALE MBI FAKTET DHE ARGUMENTET “STUDIO HAPËSIRA”:**

Pretendimet ankimore te parashtruara ne ankesën e deponuar ne OSHP, janë te njëjta.

**DEKLARATA DETALE MBI FAKTET DHE ARGUMENTET “ENG IDEA&SIB Bka”:**

Pretendimet ankimore te parashtruara ne ankesën e deponuar ne OSHP, janë te njëjta.

**Procesi i prokurimit:**

Data e njoftimit për kontratë.....	18.03.2019
Lloji i procedurës së aplikuar.....	Procedurë e hapur
Lloji dhe vlera e kontratës së publikuar.....	Kontratë publike kornizë, Shërbim
Vlera e parashikuar e kontratës.....	120,000.00€
Kriteri për dhënie të kontratës.....	tenderi i përgjegjshëm me çmim më të ulët
Afati i fundit për dorëzimin e ofertave.....	08.04.2019
Data e hapjes së ofertave.....	08.04.2019
Data e përfundimit të vlerësimit të ofertave.....	14.05.2019
Data e njoftimit të OE “Arhiko Ing OP” me letrën standarde si tenderues të pa suksesshëm.....	20.05.2019
Data e njoftimit të OE “Eng Idea&SIB Bka” me letrën standarde si tenderues të pa suksesshëm.....	20.05.2019
Data e njoftimit të OE “Studio Hapësira” me letrën standarde si tenderues i eliminuar.....	20.05.2019
Data e vendimit të AK-së për dhënie të kontratës.....	20.05.2019
Data e kërkesës për rishqyrtim “Arhiko Ing OP”.....	21.05.2019
Data e kërkesës për rishqyrtim “Eng Idea&SIB Bka”.....	22.05.2019
Data e kërkesës për rishqyrtim “Studio Hapësira”.....	21.05.2019
Data e vendimit të AK-së lidhur me kërkesën për rishqyrtim “Arhiko Ing OP”.....	23.05.2019
Data e vendimit të AK-së lidhur me kërkesën për rishqyrtim “Studio Hapësira”.....	23.05.2019
Data e vendimit të AK-së lidhur me kërkesën për rishqyrtim “Eng Idea”.....	24.05.2019



## **Kriteret për vlerësim**

### **III.2) KUSHTET PËR PJESËMARRJE**

#### **III.2.1) Kërkesat e përshtatshmërisë:**

Përshtatshmëria e OE me kërkesat e nenit 65 të Ligjit Nr.04 L-042 – për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04 L-237, ligjin Nr. 05 L068 dhe ligjin Nr. 05 L-092 deklarata nën betim.

2.Një vërtetim i nënshkruar nga Administrata Tatimore e vendit tuaj të themelimit, se ju nuk jeni me vonesë për pagimin e tatimeve së paku deri në tremujorin e fundit përpara dorëzimit të tenderit.

3.Një vërtetim nga autoriteti kompetent gjyqësor i vendit të themelimit të tenderuesit (GjTHK) se tenderuesi nuk ka pengesa lidhur me Kërkesat e përshtatshmërisë Pika 6.2 nën a,c,d,e,f dhe pika 6.3 nën a.b. dhe d. të dosjes së tenderit (deri në tremujorin e fundit përpara dorëzimit të tenderit).

#### **Dëshmia e kërkuar dokumentare:**

a. Një deklaratë nën betim se ju i përmbushni kërkesat për përshtatshmëri të Ligjit Nr.04 L-042, për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04 L-237, ligjin Nr. 05 L-068 dhe ligjin Nr. 05 L-092 e nënshkruar nga tenderuesi duke përdorur formën e Aneksi 2 në dosjen e tenderit.

b.Vërtetimi nga Administrata Tatimore - duhet të dorëzohet nga tenderuesi që propozohet për kontratë.

c.Vërtetimin nga Gjykata - duhet të dorëzohet nga tenderuesi që propozohet për kontratë. Në rast të dështimit të dorëzimit të dokumenteve nën pikën b. dhe c. tenderi në fjalë do të refuzohet.

#### **III.2.2) Përshtatshmëria profesionale:**

1.Regjistrimi në regjistrin profesional të ndërmarrjeve.

2.Regjistrimi i numrit fiskal në ATK.

3.Çertifikata e TVSH-së.

4.Certifikata PAS 99.

5. Certifikata ISO 27001.

#### **Dëshmia e kërkuar dokumentare:**

a.Vërtetimi nga Ministria për regjistrimçertifikata e biznesit me llojin e veprimtarive të regjistruara (kopje).

b.Çertifikata e numrit fiskal (kopja).

c.Çertifikata e TVSH-së (kopje).

d. Certifikata PAS 99 kopje e noterizuar.

e. Certifikata ISO 27001 kopje e noterizuar.

#### **III.2.3) Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**

1.Qarkullimi financiar në tri vitet e shkuara nga data e njoftimit për kontratë minimum 180,000.00€ (njëqindëtetëdhjetëmijëeuro).

#### **Dëshmia e kërkuar dokumentare:**

1.Raportin apo raportet përkatëse nga një ose më shumë banka për tri vitet e shkuara nga data e publikimit të njoftimit për kontratë që e pasqyrojnë këtë qarkullim.

#### **III.2.4) Kapaciteti teknik dhe profesional:**

1.Të paraqitën kontratat e shërbimeve të njëjta në tri vitet e shkuara nga data e publikimit të njoftimit për kontratë për hartim të projektve minimum tri kontrata.

2.Operatori Ekonomik të ketë një inxhinier të Arkitekturës.

3. Operatori Ekonomik të ketë një inxhinier të ndërtimtaris drejtimi konstruktiv.

4. Operatori Ekonomik të ketë një inxhinier të ndërtimtaris drejtimi hidroteknik.



5.Operatori Ekonomik të ketë një inxhinier të Gjeodezisë.

**Dëshmia e kërkuar dokumentare:**

a)Lista e kontratave - original të natyres se njejte ne 3 vitet e shkuara nga data e publikimit të njoftimit per kontratë te bashkangjiura me kopjet proceseve, raporteve te pranimeve , referenca apo te ngjajshme, ku identifikohet qarte, shuma, nr. i prokurimit, viti, titulli etj) ose proceset e pranimeve nga OE privat, me kusht qe pagesat te jane kryer nepermes institucioneve bankare.

b.Për ingjnierin e Arkitekturës të sillet diploma e tij kopje, CV-i e tij dhe kontrata e punes.

c.Për ingjnierin e ndertimtaris drejtimi konstruktiv të sillet diploma e tij kopje, CV-i e tij dhe kontrata e punes.

d. Për ingjnierin e ndertimtaris drejtimi hidroteknik të sillet diploma e tij kopje, CV-i e tij dhe kontrata e punes.

e.Për ingjnierin e Gjeodezisë të sillet diploma e tij kopje, CV-i e tij dhe kontrata e punes

**Regjistri i ofertuesve sipas procesverbalit të hapjes publike:**

Nr	Operatorët ekonomik	Vendi	Çmimi/€	Vërejtje
1.	“3D-Project”	Prishtinë	0.71€	JO
2.	“Pro Ing&Partners&Engineering Group”	Prishtinë	1.24€	JO
3.	“Infra Plus&Plan 2”	Prishtinë	3.36€	JO
4.	“Infratek&Alfa I”	Lipjan	2.96€	JO
5.	“Eng Group”	Prishtinë	1.58€	JO
6.	“Eng Idea”	Suharekë	1.77€	JO
7.	“Arhiko Ing”	Prishtinë	1.36€	JO
8.	“Studio Hapësira”	Prishtinë	1.13€	JO

**Komisioni vlerësues pranë AK:**

Autoriteti Kontraktues për vlerësimin e tenderëve ka caktuar komisionin në përbërje, si në vijim:

- Çlirim Karaqica – Kryetar i komisionit
- Jakup Shurdhaj – Anëtar i komisionit
- Ahmet Morina – Anëtar i komisionit

**Raporti i komisionit vlerësues:**

Duke u bazuar në raportin e vlerësimit, komisioni vlerësues ka konstatuar si në vijim:

- 1). OE Studio Hapësira, është i papërgjegjshëm sepse ndryshimi i çmimit e kalon vlerën 2% të gabimeve aritmetike.
- 2). OE 3D-Project, është i papërgjegjshëm sepse ndryshimi i çmimit e kalon vlerën 2% të gabimeve aritmetike.
- 3). OE Eng Group, është i papërgjegjshëm sepse i mungon Certifikata PAS 99 dhe Certifikata ISO 27001.

Raporti i ekspertit shqyrtues, lidhur me ankesën e parashtruar nga OE-të ankues, lidhur me aktivitetin e prokurimit “Hartimi i projekteve”, me numër të prokurimit: 62500-19-1228-2-2-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Komuna Malishevë.



**OE që kanë dorëzuar tender të përgjegjshëm sipas komisionit vlerësues:**

Nr.	Emri i operatorëve ekonomik që kanë dorëzuar tender të përgjegjshëm	Vendi	Çmimi
1.	Pro Ing&Partners&Engineering Group	Prishtinë	1.24€
2.	Arhiko Ing	Prishtinë	1.36€
3.	Eng Idea	Suharekë	1.77€
4.	Infratek&Alfa I	Lipjan	2.96€
5.	Infra Plus&Plan 2	Prishtinë	3.36€

Komisioni pas ekzaminimit, vlerësimit dhe krahasimit të ofertave, ka ardh në përfundim se OE ofertues “Pro Ing&Partners&Engineering Group” është i përgjegjshëm dhe të njëjtin e kanë rekomanduar për kontratë, me çmim prej: 1.24€.

Rekomandimi i komisionit vlerësues është aprovuar nga Menaxheri i prokurimit.

**Përgjigje në pretendimet ankimore të OE-ve ankues:****Përgjigje në pretendimet ankimore të OE ankues “Arhiko Ing OP” - Prishtinë.**

Eksperti shqyrtues, sqaron se OE ankues “Arhiko Ing”, njoftohet nga AK-Komuna Malishevë me letrën standarde të tenderuesit të pasuksesshëm, ndërsa në ankesën e tij ka pretendime ankimore lidhur me ofertën e të rekomanduarit për kontratë.

Eksperti shqyrtues, sqaron se OE ankues “Arhiko Ingo OP”, pretendon se i rekomanduar i për kontratë e ka dorëzuar një kontratë të menaxherit të projektit z. Isak Idrizi, i cili sipas OE ankues është profesor në Universitet të Shkupit, lidhur me menaxherin në fjale OE ankues pretendon se i njëjti nuk e ka nënshkruar vet inxhinieri dhe poashtu kërkon që të verifikohen nënshkrimet e gjithë stafit të inxhinierëve me kopje të letrënjoftimit.

Lidhur me pretendimet e lartpërmendura eksperti shqyrtues, sqaron se të gjitha këto pretendime janë në kompetencë të organeve të hetuesisë dhe nuk janë kompetencë lëndore e OSHP-se për të krahasuar origjinalitetin apo autenticitetin e nënshkrimeve. Ndërsa sa i përket pretendimit lidhur me kontratën e menaxherit të projektit eksperti shqyrtues sqaron se kontrata është sipas kërkesës së dorës së tenderit dhe lidhur me nënshkrimin e vendosur në këtë kontratë nuk mund të konstatohet se është bërë falls pasi që siç u sqaruar edhe me lart nuk është në kompetencë të OSHP-se.

Lidhur me pretendimin e OE ankues, që ka të bëjë me formularin e tenderit të OE të rekomanduar për kontratë, për të cilin pretendon se i njëjti nuk e ka përdorur nënshkrimin e avancuar digjital, eksperti shqyrtues sqaron se ky pretendim është i paqëndrueshëm për faktin se formulari i dorëzuar nga i rekomanduari për kontratë i përmban të gjitha të dhënat e nevojshme duke përfshirë nënshkrimet, vulat, ndërsa sa i përket nënshkrimit digjital apo të avancuar në fund të nenit 399 të RrUOPP-se, është dhënë sqarimi se nuk janë të obligueshme deri në njoftimin zyrtar nga KRPP-ja.

Sa i përket pretendimit të OE ankues, se anëtar i konzorciumit, i ka dorëzuar certifikatat e biznesit të vjetra dhe sipas OE ankues, nuk janë me valide, eksperti shqyrtues sqaron se certifikatat e vjetra janë valide deri në Shtator të vitit 2019 sipas udhëzimit administrativ të MTI-se të publikuar në ueb faqe.

Eksperti shqyrtues, lidhur me pretendimin e OE ankues që ka të bëjë me kontratat dhe referencat e dorëzuara nga i rekomanduari për kontratë, për të cilin pretendon se nuk ka asnjë dëshmi që punët janë kryer por i ka



dorëzuar vetëm kontratat e nënshkruara, eksperti shqyrtues sqaron se është i paqëndrueshëm ky pretendim për faktin se ne ofertën e OE te rekomanduar për kontratë gjenden raportet e pranimit teknik dhe referencat për projektet e përfunduara dhe njëherit eksperti shqyrtues, sqaron se ky pretendim nuk ka qene i parashtruar ne kërkesën për rishqyrtim.

Duke u bazuar ne sqarimet e dhëna me larte eksperti shqyrtues vlerëson se pretendimet ankimore te OE ankues “Arhiko Ing OP” janë te pabazuar.

#### **Përgjigje në pretendimet ankimore të OE ankues “Studio Hapësira” - Prishtinë.**

Eksperti shqyrtues, sqaron se OE ankues “Studio Hapësira”, eliminohet nga ky aktivitet i prokurimit, me arsyetimin se pas ekzaminimit te ofertës financiare rezulton qe çmimi i ndryshuar pas llogaritjes se gabimeve aritmetike, e kalon 2 % e vlerës se ofertës te parapare ne nenin 59 te LPP-se.

Eksperti shqyrtues, lidhur me arsyen e eliminimit dhe pretendimin e OE ankues se nuk e kemi kaluar pragun prej 2% te gabimeve aritmetike, sqaron se OE ankues ne ofertën e tij financiare ka dhënë totalin e peshuar 1.13 euro.

Gjatë vlerësimit te ofertave AK-ja, përkatësisht komisioni vlerësues ka vërejtur se oferta financiare e OE ankues “Studio Hapësira”, ka gabime aritmetike dhe pas përlllogaritjes komisioni ka konstatuar vlera e përmirësuar e tejkalon 2 % e parapare ne nenin 59 te LPP-se, me arsyetimin se ne hapje vlera ka qene 1.13 euro, ndërsa pas përmirësimit rezulton te jet 1.155 euro.

Eksperti shqyrtues, pasi ka analizuar dosjen e tenderit sqaron se ne piken 20.1 te dosjes se tenderit AK-ja ka dhënë sqarimin se: Të gjitha çmimet e specifikuar në tender duhet të deklarohen në Euro (€) dhe duhet të përfshinë të gjitha taksat e aplikueshme, detyrat dhe pagesat tjera. Çmimi i ofertuar lejohet qe te shënohet me maksimum dy (2) numra pas presës dhjetore. Çdo numër i shënuar pas numrit të dytë (2) nuk do të merret për bazë në llogaritje të vlerës së ofertës.

Duke u bazuar ne sqarimin e lartshënuar AK-ja, gjate vlerësimit apo llogaritjes se çmimit nuk është dashur ta merr për bazë numrin e tret pas presjes dhjetore, qe ne rastin konkret ka rezultuar te jet 1.155, te cilin AK-ja e ka llogaritur gjate vlerësimit.

Eksperti shqyrtues, vlerëson se AK-ja, ne këtë rast nuk i ka respektuar procedurat e vlerësimit sipas sqarimeve te dhëna ne dosje te tenderit. Prandaj, eksperti shqyrtues vlerëson se ankesa e OE ankues “Studio Hapësira” është bazuar për faktin se AK-ja, gjate vlerësimit duhet ti marr për bazë vetëm kriteret e vendosura ne dosje te tenderit. Me saktësisht AK-ja, gjatë rivlerësimit te ofertave nuk duhet te marr parasysh asnjë numër pas numrit te dYTE pas presjes dhjetore.

#### **Përgjigje në pretendimet ankimore të OE ankues “Eng Idea&SIB Bka” - Suharekë.**

Eksperti shqyrtues, sqaron se OE ankues “Eng Idea&SIB Bka”, njoftohet nga AK-Komuna Malishevë, si tenderues i pasuksesshëm, ndërsa ne ankesën e tij ka pretendime ankimore lidhur me ofertën e OE te rekomanduar për kontratë dhe ofertën e dYTE me radhë sipas çmimit.

OE ankues, ne ankesën e tij për ofertën e te rekomanduarit për kontratë ka pretendime se ka ofruar ofertë me çmime jo/normalisht te ulet dhe njëherit per te njëjtin pretendim ne ankesën e tij e ka paraqitur edhe tabelën sipas rregullores për çmime Jo/Normalisht te ulet, sipas se cilës pragu për tu konsideruar ofertë me çmim jo/normalisht te ulet janë ofertat nen vlerën:1.59 euro.

Eksperti shqyrtues, sqaron se AK-ja, gjate vlerësimit te ofertave nuk i ka zbatuar procedurat e nenit 61 te LPP-se dhe Rregulloren për çmime Jo/Normalisht te ulëta, prandaj ky pretendim i OE ankues është pjesërisht



i qëndrueshëm, për faktin se sipas nenit 61 të LPP-se, është e drejte e AK-se që të vlerësojë çmimin e ofruar nga OE, mirëpo fakti që AK-ja nuk i ka zbatuar procedurat e rregullores së lartpërmendur ky pretendim është pjesërisht i qëndrueshëm.

Lidhur me pretendimin e OE ankues, se OE “Arhiko Ing OP”, në ofertën e tij ka dorëzuar diplomën e inxhinierit Gjeodet në gjuhë Kroate dhe të njëjtën diplomë nuk e ka përkthyer në asnjërën nga tri gjuhët zyrtare të parapara në LPP, eksperti shqyrtues, sqaron se ky pretendim është i qëndrueshëm për faktin se OE “Arhiko Ing OP”, në ofertën e tij e ka dorëzuar diplomën në gjuhën Kroate të inxhinierit Hebib Alili, të papërkthyer në asnjërën nga tri gjuhët e parapara në nenin 13 të LPP-se.

Sa i përket pretendimit të OE ankues, AK-ja nuk ka ofruar qasje në çmimet e ofruara nga OE, eksperti shqyrtues, sqaron se në bazë të shkresave të lëndës qasja është aprovuar nga AK-ja, ndërsa fakti se sa ka pasur mundësi të qaset OE në dokumentet e kërkuara eksperti shqyrtues nuk mund ta konstatojë një fakt të tillë. Prandaj i mbetet AK-se që ta sqarojë këtë situatë.

### **Mendimi i ekspertit shqyrtues**

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues “Arhiko Ing OP” të refuzohet si e pa bazuar, ndërsa ankesa e OE-ve ankues “Studio Hapësira” dhe “Eng Idea&SIB Bka” të aprovohen si të bazuara, ndërsa vendimi i AK-se për dhënie të kontratës të anulohet që lënda të kthehet në rivlerësim.